

**VENDIM**  
**Nr. 343, datë 19.6.2025**

**PËR CAKTIMIN E MINISTRISË SË FINANCAVE SI PËRFAQËSUESE TË  
SHTETIT SHQIPTAR NË CILËSINË E AKSIONARIT TË PARË TË SHOQËRISË  
“BANKA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 23/2025, “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Caktimin e Ministrisë së Financave si përfaqësuese të shtetit shqiptar në cilësinë e aksionarit të parë të shoqërisë “Banka Shqiptare e Zhvillimit” sh.a.
  2. Ministria e Financave përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë “Banka Shqiptare e Zhvillimit” sh.a.
  3. Ngarkohet Ministria e Financave për ndjekjen e procedurave të mëtejshme, në zbatim të ligjit nr. 23/2025, “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”.
  4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe shoqëria “Banka Shqiptare e Zhvillimit” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**